



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 612/2 Prot.

Tiranë, më 22.04 2021

V E N D I M

Nr. 20 dt. 22.04 2021

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË EMËRTIMIN E  
DEPARTAMENTEVE TË INSTITUTIT TË KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT NË  
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, pika 6, neni 49, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, neni 43, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 42 datë 19.04. 2021”Për miratimin e disa ndryshimeve në emërtimin e departamenteve të IKSHS në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.04.2021,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në emërtimin e Departamenteve të Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit në Universitetin e Sporteve të Tiranës, si më poshtë vijon;
  - a) Departamenti i Kërkimit në Veprimtarinë Fizike, Shëndetit dhe Rekreacionit të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Performancës Sportive**”
  - b) Departamenti i Kërkimit Shkencor të Lëvizjes së Aplikuar, të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit**”
  - c) Departamenti i Kërkimit dhe Studimit të Tregut të Punës dhe të Transferimit të Teknologjisë të ndryshojë me emërtimin “**Departamenti i Projekteve dhe Teknologjisë**”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Rektorati i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim nuk ka efekte financiare publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

TARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI

